



DEKLARATË NOTERIALE

Në Tiranë, sot më datë 24.01.2020 (dy mijë e njëzetë), para meje noteres Eriketa KOKOLI, me adresë në Rr. "Sami Frashëri", Pallati i Ri pranë Drejtorisë së Policisë, Kati IV, Tiranë, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit:

DEKLARUESI: "BANKA e TIRANËS" SH.A, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.12718, datë 03.11.1995, NIPT J61924008V, që vepron si BANKË me Licensën Nr.07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me seli në Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtores e Divizionit të Korporatave, znj. Glenda Kurti**, e bija e Agronit, lindur me 06.03.1978, në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresën Rr. "Kongresi i Manastirit", Pall. ½, Shkalla 3, identifikuar me pasaportë Nr. H85306150N dhe nga **Drejtores e Departamentit të Administrimit të Kredive, Aida CENGU**, e bija e Azemit, linë më 16.02.1970 në Kukës, banuese në adresën Rr. "M.Fortuzi", Nd.2, H.14, Ap.3 Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr.025225466, të dy madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan sa më poshtë vijon:

Shoqëria "BANKA e TIRANËS" SH.A, i ka akorduar Kredimarresit shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k (NUIS J81813004C) një kredi bankare sipas Kontratë për Kredi Afat Gjatë Nr.957/26.12.2019 me Nr.22Rep/Nr.07Kol datë 08.01.2020 të noteres Eriketa Kokoli, në shumën prej EUR 4,000,000 (katër milion euro).

Per te siguruar shlyerjen e kësaj kredie, është vendosur barrë siguroese dhe peng **ne favor te "BANKA e TIRANES" Sh.A mbi** aksionet që zotëron **z.Alban Xhaferi** në kapitalin e shoqërisë "**BIRRA TIRANA**" SH.P.K (NIPT J61821051F) si më poshtë:

- (i) *162,313 (njqind e gjashtedhjetë e dy mijë e treqind e trembedhjetë) aksione (pjesëve të kapitalit) me vlerë nominale 1,000 Lekë (nje mijë lekë) secila, të zotëruara prej Barrëdhënësit në kapitalin e shoqërisë "Birra e Tiranës" sh.a (NUIS Nr.J61821051F) dhe që përfaqësojnë 14.62% të kapitalit të kësaj shoqërie; si dhe*
- (ii) *çdo aksion të ri të shoqërisë "Birra Tirana" sh.a që mund të fitohet në të ardhmen prej Barrëdhënësit nëpërmjet kapitalizimit të fitimeve, rritjes së kapitalit etj; si dhe*
- (iii) *të gjitha të drejtat që rrjedhin në çdo mënyrë, direkt ose indirekt, nga zotërimi i Kolateralit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në të drejtën e dividendëve (fitimeve) dhe të drejtën e votimit në asamblenë e aksionarëve lidhur me Kolateralin.*

Kjo vertetohet me Marrëveshjen Siguroese me Nr. 24Rep e Nr. 9Kol, date 08.01.2020 te noteres Eriketa KOKOLI si dhe Kontratës së Pengut mbi Kuotat me Nr.27Rep/Nr.12Kol datë 08.01.2020 të noteres Eriketa KOKOLI, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me datë 15.01.2020 dhe në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve më datë 13.01.2020.

Meqenese mbi *162,313 (njqind e gjashte dhjetë e dy mijë e treqind e trembedhjetë) aksione* pjesë të kapitalit me vlerë nominale 1,000 Lekë (nje mijë lekë) secila, të zotëruara nga **z.Alban XHAFERI** në kapitalin e shoqërisë "**BIRRA TIRANA**" SH.P.K (NUIS Nr.J61821051F) dhe që përfaqësojnë 14,62 % të kapitalit të kësaj shoqërie është vendosur barrë siguroese dhe peng ne favor te "BANKA e TIRANES"

SH.A, me kete deklarate ne japim pelqimin per:

- a) kalimin e pronesisë së aksioneve dhe respektivisht pjesës prej **14,52% (katërmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy përqind)** të kapitalit të shoqërisë “BIRRA TIRANA” SH.P.K (NUIS Nr.J61821051F) nga **Shitësi z.Alban XHAFERI tek Blerësi shoqëria “HYSENBELLIU” SH.P.K me kushtin që mbi këto aksione të vazhdojnë të qëndrojnë të rënduara me peng dhe barrë siguruese në favor të “BANKA e TIRANES” Sh.a;**
- b) **lirimin e pengut të regjistruar në favor të “Banka e Tiranës” sh.a në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, mbi 0,1 % (zero pikë një përqind) të aksioneve që z.Alban Xhaferi zotëron tek shoqëria “Birra Tirana” sh.a pasi këto aksione në masën prej 0,1 % (zero pikë një përqind) do të vijojnë të mbeten në pronësi të z.Alban Xhaferi.**

Pra, kalimi i pronësisë së aksioneve në masën prej 14,52 % (katërmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy përqind) të zotëruara nga Shitësi z.Alban XHAFERI ne emer te Blerësit shoqërisë “HYSENBELLIU” SH.P.K. duhet te behet se bashku me barren siguruese/pengun ne favor te “BANKA e TIRANES” Sh.a dhe pa cenuar te drejten e saj si dhe lirimin nga pengu i regjistruar në favor të “Banka e Tiranës” sh.a mbi 0,1 % (zero pikë një përqind) të aksioneve që z.Alban Xhaferi zotëron në shoqërinë “Birra Tirana” sh.a.


Gjithashtu, ne japim pelqimin tone per kryerjen e veprimeve perkatese nga Zyra e Noterise, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Qendra e Regjistrimit të Aksioneve.

Kjo Deklaratë Noteriale u përpilua nga unë Noteri në 6 (gjashtë) origjinale konform vullnetit të lirë të Deklaruesve, të cilëve pasi ju lexua me zë të lartë dhe pasi e gjetën sipas vullnetit të tyre, e nënshkruan rregullisht para meje NOTERIT.

DEKLARUES

“BANKA e TIRANËS” SH.A.
përfaqësuar nga:


Drejtoresh e Divizionit të Korporatave


Drejtoresh e Departamentit të Administrimit të Kredive

NOTERE

ERIKETA KOKOLI

